






K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. Prizren  
Adresa: Wesley Clarc p.n., 20000 Prizren  
Email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com  
Tel/Fax: 029/244-150

»HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.

789

27.03

PRIZREN

<b>DATA:</b>	27.03.2023
<b>REFERENCË:</b>	Vendimi nr. 509, datë; 27.02.2023, Konkursi i datës 22.02.2023, pozita; Gjeodet në njësinë punuese Prizren
<b>PËR:</b>	z. Zenel Zenelaj, Kryeshef Ekzekutiv i KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, Prizren
<b>NGA:</b>	<b>Vendimi i komisionit për vlerësim dhe përzgjedhje të kandidatit:</b>  1. Albert Salltakaj,  2. Gent Bytyçi,  3. Ilire Bujari, 
<b>TEMA</b>	<b>Vendim për vlerësim dhe përzgjedhje të kandidatit</b>

Konform vendimit nr.509 të datës: 27.02.2023 për formimin e komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve të konkuruar sipas konkursit të datës 22.02.2023; Gjeodet në njësinë punuese - Prizren, komisioni në përbërje të plotë konform rregullores nr. 01-12/02 Komisioni i Përzgjedhjes me datë: 27.03.2023 nxjerr:

## VENDIM

### PËR SHPALLJEN E REZULTATEVE TË PRANIMIT SIPAS KONKURSIT

Komisioni i përzgjedhjes shpall rezultatet e pranimit të kandidatit sipas konkursit të datës: 22.02.2023, të publikuar nga KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A për vendin e punës: Gjeodet në njësinë punuese Prizren, si dhe pranohet Kandidati: Rilind Elshani që fitoi 75.5% të pikëve të fituara.

## A r s y e t i m

Në vlerësimin e kandidatëve komisioni ka patur parasysh këto kritere:

- Kushtet e konkursit
- Përgjigjet gjatë dy fazave të intervistimit
- Njohja e gjuhëve të huaja
- Aftësitë komunikuese dhe kualitetet tjera të veçanta

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur lista e kandidatëve që kaluan pjesën e intervistimit me shkrim mbi 50 % dhe të cilët iu nënshtruan fazës së intervistimit me gojë.

Nr.	Emri Mbiemri	Faza I (pikë)	Faza II (pikë)	Totali (%)
1	Rilind Elshani	61	90	75.50%
2	Njomza Januzi	51	92	71.50%

Pas vlerësimit dhe poentimit nga anëtarët e komisionit veç e veç rezultojnë se kandidati: **Rilind Elshani**, fiton numrin më të madh të pikëve (testi me shkrim dhe intervista, përkatësisht testi me shkrim: 61 pikë dhe intervista: 90 pikë, dhe i njëjti përzgjidhet për vendin e punës; **Gjeodet në njësinë punuese Prizren**

**Këshillë juridike:** Aplikuesi i pakënaqur me vendimin për përzgjedhje mund të ushtroj ankesë në afat prej tetë (8) ditësh nga pranimi i vendimit, ankesa i drejtohet komisionit të ankesave përmes Zyrës së Burimeve Njerëzore në KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A.